

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**BASHKINË PATOS**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Patos**, me objekt: “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më 31.12.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 108, datë 03.09.2015.

Bazuar në nenet 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 31/11, datë 03.09.2015, i ka rekomanduar z. Rajmonda Balili, Kryetar i Bashkisë Patos, zbatimin e masave të mëposhtme:

Ky vendim është i përbashkët për të dy auditimet e kryera (Auditimi me programin nr.31/1, datë 16.01.2015, përgatitur si Raport Përfundimtar në muajin Maj 2015, dhe riauditimi me programin nr. 31/5, datë 01.06.2015 audituar në muajin Korrik 2015. Raporti i auditimit i paraqitur nga grupi i parë i audituesve shtetërorë, në vlerësimin e kryer nga Kryetari i KLSH dhe Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, u vlerësua auditim i dobët dhe që nuk plotëson programin e auditimit, kryesisht në pikën 6 “Auditimi mbi prokurimin e fondeve publike për mallra e shërbime dhe zbatimin e kontratave”. Auditimi i grupit të parë nuk ishte i thelluar dhe nuk kishte mbuluar plotësisht procedurat e prokurimit publik të kryer në këtë bashki dhe nuk ishin audituar sipas standardeve zbatimi i kontratave, të cilat ishin me risk të lartë. Për këtë është vendosur që të kryhet riauditim me programin nr. 31/5, datë 01.06.2015, i cili është kryer nga data 03.06.2015 deri më 15.07.2015.

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje:** Bashkia Patos nuk ka ndjekur procedurat ligjore për detyrat e lëna nga KLSH në auditin e mëparshëm, në drejtim të masave të rekomanduara për shpërblim dëmi ku për 10 masa me vlerë 26,757,000 lekë, janë zbatuar 3 masa me vlerën 4,098,022 lekë, një masë në vlerën 640,548 lekë është akoma në procedure ndjekje, duke mbetur pa u zbatuar 6 masa me vlerë **vlerën 22,018,430 lekë**, si dhe nga 2 masa administrative me gjobë **100,000 lekë** në ngarkim të punonjësve nuk është arkëtuar dhe kontabilizuar.

**Rekomandim:** Të merren masa të menjëhershme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës **22,018,430 lekë**, si dhe arkëtimin e gjobës në vlerën **100,000 lekë**.

**2. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Patos nuk ka marrë masa për implementimin e plotë të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

**Rekomandim:** Bashkia Patos të marrë masa për implementimin e plotë të sistemit të Menaxhimit Financiar e Kontrollit, duke ndjekur të gjitha detyrat e lëna deri në realizimin e plotë të tyre.

**3. Gjetje:** Bashkia Patos ka punonjës që nuk plotësojnë kriteret për të qenë auditues të brendshëm, nuk janë të pajisur me certifikatë si auditues të brendshëm, veprime këto në kundërshtim me neni 19, Punësimi, Pika 2 kreu VI, Audituesi i Brendshëm të ligjit nr. 10318, datë 16.9.2010, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

**Rekomandim:** Të merren masa dhe të rishikohen pozicionet e punës për punonjësit pa përvojë audituese dhe pa certifikatë të auditit të brendshëm, duke zbatuar afatet e caktuara nga ligji.

**4. Gjetje:** Nuk janë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga subjektet debitorë të viti 2013 dhe viti 2014 (biznese dhe familjarë), për taksën e pastrimit, taksën e ndriçimit dhe gjelbërimit në vlerë **6,228,872 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenin 12 si dhe udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve”, pika 88 dhe pika 89.2, pika 89.3, dhe pika 96 .

**Rekomandimi:** Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me zyrën e Financës dhe zyrën Juridike, të ndjekin të gjitha procedurat ligjore, për arkëtimin e plotë të detyrimeve të subjekteve debitorë me vlerë **6,228,872 lekë**.

**5. Gjetje:** Nuk janë planifikuar drejt të ardhurat për taksën e regjistrimit, taksën e popullatës, për pasurinë, pastrimin, gjelbërimin si dhe taksën e ndriçimit dhe pastrimit (biznes i vogël dhe biznes i madh dhe popullatën), në vlerën **19,654,000 lekë** që i përkët vitit 2013 dhe 2014, veprime në kundërshtim me nenin 12, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemimin e taksave vendore”.

**Rekomandim:** Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak Patos, të planifikojë të ardhurat sipas numrit të familjeve, numrit të bizneseve të vogël dhe të madh, që ka në juridiksionin kjo Bashki.

**6. Gjetje:** Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore, nuk ka planifikuar taksën e tokës bujqësore për vitin 2013 dhe vitin 2014 në vlerën **7,268,000 lekë**, për sasinë të tokës bujqësore që ka në juridiksion Bashkia Patos, si dhe nuk ka ndjekur procedurat ligjore për arkëtim të taksës së tokës bujqësore në vlerën **1,897,000 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8982, datë 12.12.2002 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 12 (Taksa mbi tokën bujqësore) dhe Kreu XI ” Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime .

**Rekomandim:** Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të planifikojë taksën e tokës bujqësore në vlerën **7,268,000 lekë**, sipas sasisë së tokës që disponon kjo Bashki, si e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë, të ndjekë të gjitha mënyrat për arkëtimin e vlerës **1,897,000 lekë**, në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të ndjekë të gjitha hapat ligjore për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve.

**7. Gjetje nga auditimi:** Gjatë vitit 2013 dhe vitit 2014, INUV ka punuar në kundërshtim me nenin 82, pika 4, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikim e territorit”, si dhe nenin 52 pika 1, germa ‘c’, të ligjit nr. 107/2014, miratuar në datë 31.07.2014 “Për planifikim dhe zhvillimin e territorit”, sepse për rastet e konstatimit “Mos deklarimi i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje”, nuk janë aplikuar gjoba, kërkesë kjo dhe e nenit 41 të ligjit të sipërcituar.

**Rekomandimi:** “Për të gjitha rastet e konstatuara e të dokumentuara në procesverbale, me objekt “Mosdeklarimi i punimeve që përjashtohen nga detyrimi i pajisjes me leje”, të merren masa administrative me gjobë në zbatim të kërkesave ligjore.

**8. Gjetje:** Emërimi i punonjësve të Policisë Bashkiake është bërë në kundërshtim me neni 4 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, i tij, si dhe Urdhrit të Përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003.

Për vitin 2012-2014, nuk ka gjetur zbatim neni 13, të ligjit nr. 8224 datë 15.05.1997, paragrafi i parë, ku citohet: “Për shkeljet e vërejtura punonjësit e policisë së bashkisë dhe të komunës kanë të drejtë të gjobitin në vend personat përgjegjës” .

**Rekomandimi:** Të zbatohen të gjitha procedurat ligjore për emërimin e punonjësve të Policisë Bashkiake, si dhe për shkeljet e konstatuara të analizohen e të nxirët përgjegjësia administrative me gjobë dhe disiplinore.

**9. Gjetje:** Gjatë vitit 2013 dhe vitit 2014, Kryeinspektori dhe inspektorët e INUV në Bashkinë Patos janë përzgjedhur në kundërshtim të plotë me kërkesat e nenit 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, e konkretisht, “Kryeinspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku/kombëtar, duhet të kenë arsimin të lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

**Rekomandimi:** Bashkia Patos të marrë masa dhe të zbatojë të gjitha procedurat ligjore për emërimin e punonjësve të INUV .

**10. Gjetje:** Në 7 raste të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit “me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës”, autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me nenin 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit”, të LPP, dhe pikës 5, kreu IV, të

VKM nr. 1, datë 10.01.2007, për arsye se, nuk kanë ekzistuar kushtet e përcaktuara në dispozitë për përdorimin e përdorimit të kësaj procedure prokurimi. Rrethanat që kanë çuar në zgjedhjen e këtyre procedurave të prokurimit janë subjektive e të shkaktuara nga neglizhenca të autoritetit kontraktor .

**Rekomandim:** Bashkia Patos, të përdorin vetëm për raste të veçanta procedurën “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, pasi me ndjekjen e zbatimit të kësaj procedure dhe jo me procedurën “e hapur”, autoriteti kontraktor, në mungesë të konkurrencës nuk arrin të realizojë plotësisht nevojat për mallra, punë e shërbime në sasi por me të njëjtat ose më pak burime, si dhe duhet të merren gjithashtu në konsideratë **ekonomiciteti, eficienta dhe efektiviteti** në zhvillimin e procedurave të prokurimit, si detyrë e njësisë së qeverisjes vendore.

**11.Gjetje:** Autoriteti Kontraktor në **7 raste** në vlerën **64.821.924 lekë**, ka realizuar procedurën e prokurimit publik në mungesë të fondeve, në kundërshtim me pikën 4/c të kreu V, të VKM nr. 1, datë 10. 01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 50, të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

-Nuk është dërguar në APP një raport i prokurimeve të realizuara, të kryera gjatë vitit 2013 dhe 2014, duke mos respektuar kërkesat e pikës 3/d kreu I i VKM nr. 1, datë 10.1.2007 dhe “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenit 4 Kreu I, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

-Nuk është dërguar në APP, përmbledhja e regjistrit të veprimtarive të prokurimeve të kryera gjatë vitit paraardhës (vitit 2013), të cilat duhet të ishin dorëzuar në APP, jo më vonë se data 30 janar 2014 për prokurimet e realizuara në vitin 2013, sipas pikës 3/d, kreu I-rë i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 dhe - 20 janar 2015 për prokurimet e realizuara vitit 2014, sipas pikës 2, neni 7 i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Rekomandim:** Bashkia Patos të marrin masa për hartimin e raportit të realizimit të prokurimeve dhe regjistrit të hartuar të realizimit të prokurimeve publike të vitit ushtrimor të dërgohen në Agjencinë e Prokurimeve Publike në përputhje me kërkesat e nenit 4 dhe nenit 7, Kreu I, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë .29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, pikës 7 dhe 8 e Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2, datë 27.01.2015 “Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrit të Realizimeve të Prokurimit Publik”.

### **12.Gjetje:**

-Për dosjet të arkivuara me status të përfunduar janë konstatuar raste( Blerje Rëre Bituminoze, Rikonstruksion i Rrugës së Kripallarëve, Rikonstruksion i Rrugës Demokracia) që arkivimi i kontratës së lidhur është bërë me vonesë nga botimi i kontratës së lidhur, duke mos zbatuar afatin e përcaktuar të arkivimit të procedurës brenda 1 dite pune nga mbyllja e fazës së njoftimit të kontratës së lidhur, e përcaktuar kjo në Urdhrin nr. 57, dt. 12.06.2014 dhe Udhëzimin e Agjencia e prokurimit publik nr. 3, datë 01.06.2010 "Për shpalljen e njoftimit të kontratës, njoftimit të fituesit dhe njoftimit të kontratës së lidhur në sistemin e prokurimit elektronik" i ndryshuar, me udhëzimin nr.2, datë 03.04.2014.

-Konstatohen raste të procedurave cilat rezultojnë me arkivimi i kontratës me status të papërfunduar, ndërkohe që njoftimi i lidhjes së kontratës rezulton me status të përfunduar.

**Rekomandim:** Bashkia Patos të marrin masa të bëjnë mbylljen e arkivimeve të kontratave për procedurat e prokurimeve të përfunduara dhe në të ardhmen aktivimi i kontratave të lidhura të bëhet brenda 1 dite pune nga mbyllja e fazës së njoftimit të kontratës së lidhur, me qëllim që edhe faza e fundit e të arkivimit të procedurave të prokurimeve elektronike - Arkivimi i kontratës të rezultoi me status të përfunduar, dhe brenda afatit të përcaktuar.

### **13. Gjetje nga auditimi:**

-Në përcaktimet dhe miratimet e kritereve të veçanta të kualifikimit, ka mangësi, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme nuk i plotësojnë kushtet e nenit 55, pika 1, e LPP-së, pasi nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës;

nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderave.

-Kriteret e përdorura për vlerësimin e ofertave nuk janë specifikuar në mënyrë të saktë nga ana e autoritetit kontraktor, për rrjedhojë lejojnë Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, t'i interpretojnë ato në mënyra të ndryshme në proceduar të ndryshme madje në disa raste me impakte financiar në dëm të autoritetit kontraktor ***në vlerën 15,626,332 lekë nga e cila 2,458,440 lekë në 2 kontrata me vlerë 14,284,210 lekë në vitin 2013 dhe 13,167,892 lekë në 7 kontrata me vlerën 65,417,953 lekë në vitin 2014.***

-Dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kriterëve të kualifikimit, nuk kanë argumentim me hollësi të tyre, kjo në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, Kreu III, pika 3, germa “a” si dhe me nenin nr. 46 të LPP-së, pikën nr. 3. Nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomik, veçanërisht biznesit të vogël. Kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

***KVO ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kriterëve të kualifikim-pranimit të operatorëve pjesëmarrës në procedurat e zhvilluara për periudhën 2013-2014.***

Konkretisht, ka s'kualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin, ekonomik, financiar dhe teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit të gjithë operatorët ekonomik, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës; dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues vetëm 1 OE kur dokumentacioni i paraqitur për të vërtetuar kapacitetet ekonomike, financiare dhe teknike është në kundërshtim me DST ( kriteret e veçanta të kualifikimit ), nenin 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe me piken 4, të Kreut V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e prokurimit publik”., i ndryshuar. Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirepërdorimi i fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke i bërë që ***15,626,332 lekë*** fonde buxhetore të mospërdoren me efektivitet dhe të mos kursehen në favor të buxhetit të bashkisë Patos.

**Rekomandim:** Autoriteti kontraktor të forcojnë kontrollin e brendshëm në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit. Konkretisht:

Në parashikimin e nevojës për prokurimi, kërkesës për prokurim dhe miratimi i saj; hartimin dhe miratimin e urdhrin për zgjedhjen e procedurës së prokurimi, ngritjen e komisionit të vlerësimit, fondit limit dhe specifikimeve teknike.

Vlerësimin dhe nënshkrimin e procesverbalit për llogaritjen dhe argumentimin e vlerësimit të kontratës si dhe hartimin dhe vlerësimin e specifikimeve teknike.

Në hartimin e projektit të zbatimit dhe preventivit; hartimin dhe miratimin e urdhrin të prokurimit; në përgatitjen, miratimin dhe hedhjen në sistem e dokumenteve të tenderit. Ngritjen e komisionit dhe vlerësimit të ofertave; miratimin e raportit narrativ përmbledhës; njoftimin e ofertës fituese. Ngritjen e grupit ad-hoc dhe shqyrtimin e ankimeve. Përgatitjen, miratimin, nënshkrimin e kontratës dhe pagesa e sigurimit të saj, mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës, kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të punimeve, mallrave dhe shërbimeve, likuidimin e transaksioneve dhe zbatimin e detyrimeve kontraktuale.

#### **14.Gjetje nga auditimi:**

Në mbështetje të Urdhrin të Ministrit të Financave nr. 57 datë 11.6.2014, pika nr.3 në të cilën përcaktohet që: “në referim të gjurmës standarde të auditimit, Titullari i çdo njësie publike të

qeverisjes së përgjithshme të hartojë gjurmën e detajuar të auditimit për njësitë që drejtojnë”, duhet të ishte hartuar e miratuar gjurma e detajuar e auditimit, e cila do të përbëjë një bazë të hapave dhe procedurave që duhet të ndjekin të gjitha strukturat e Bashkisë në këtë proces.

**Rekomandim:** Bashkia Patos, të marrë masa për hartimin e gjurmëve të detajuara të auditimit për prokurimet publike dhe ta paraqesë për miratim te titullari i autoritetit kontraktor në cilësinë e nëpunësit autorizues.

**15.Gjetje:** Në **7 procedura prokurimi**, është konstatuar se, kanë përfituar padrejtësisht TVSH për pajisje, ndërkohë që kërkesat ligjore e ndalojnë llogaritjen dhe pagesën e tvsh për pajisje e makineri nga subjektet pjesëmarrëse në procedurë e prokurimit.

**Rekomandimi:** Bashkia Patos të ngrejë një komision me specialistë të fushës të cilët të rillogarisin dhe arkëtojnë nga operatorët ekonomik fitues, vlerat e përfituar në kundërshtim me kërkesat ligjore në fuqi.

**16.Gjetje:** INUV Patos nuk janë planifikuar kontrole në drejtim të:

- ushtrimit të kontrolleve periodike për stafin teknik të zbatimit për cilësinë e materialeve të ndërtimit si dhe dokumentacionin e detyrueshëm që duhet të mbahet në objekt;
- provave laboratorike të materialeve që përdoren në ndërtimin e objekteve, kryesisht betone, hekur, llaçe, inerte etj;
- në drejtim të mbikëqyrjes nga specialist të licencuar dhe kolaudimit pas përfundimit të punimeve;
- në drejtim të projekteve të zbatimit të ndërtimeve pa leje si dhe gjithë detyrave që përcakton në mënyrë më analitike VKM nr. 862, datë 05.12.2007 (Trajtuar më hollësisht në faqet 208-218, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Rekomandim:** Nga INUV në programet e punës të planifikohen kontrole në drejtim të:

- stafit teknik të zbatimit për cilësinë e materialeve të ndërtimit si dhe dokumentacionin e detyrueshëm që duhet të mbahet në objekt;
- provave laboratorike të materialeve që përdoren në ndërtimin e objekteve, kryesisht betone, hekur, llaçe, inerte etj;
- në drejtim të mbikëqyrjes nga specialist të licencuar dhe kolaudimit pas përfundimit të punimeve;
- në drejtim të projekteve të zbatimit të ndërtimeve pa leje si dhe gjithë detyrave që përcakton në mënyrë më analitike VKM nr. 862, datë 05.12.2007.

**17.Gjetje:** Bashkia Patos nuk ka zbatuar plotësisht kërkesat e dispozitave ligjore për procedurat e transferimit të pronave në NJQV-ve dhe konkretisht të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.

Bashkia Patos nuk ka zbatuar pika 6, e VKM së mësipërme e cila përcakton shprehimisht:

“ZVRPP përgatit listat e pronave shtetërore, të regjistruara ose në proces, për çdo zonë kadastrale, posaçërisht për miratimin e inventarit nga Këshilli i Ministrave. Këto lista duhet të sqarojnë çdo pronë: indeksin e hartës, numrin e pasurisë, adresën, llojin e pronës, sipërfaqen e pronës dhe çdo specifikim tjetër, të nevojshëm, që ndodhet në ZVRPP”.

-pika 7 e VKM së mësipërme e cila përcakton shprehimisht:

“ZVRPP-të e rretheve janë të detyruara të lejojnë përfaqësuesit e autorizuar të organeve të pushtetit vendor dhe të organeve të qeverisjes vendore të shfrytëzojnë, për efekt të zbatimit të këtij vendimi, “Librin e ngastrave” dhe kartelat e regjistrimit të pasurive.

dhe pika 13 e VKM së mësipërme .

Nga auditimi rezultoi se lista e pasurive të dërguara për miratim në asnjë rast nuk shoqërohet me planvendosjen dhe planimetrinë e objekteve” .

**Rekomandim:** Nga Bashkia Patos të merren të gjitha masat tekniko-organizative për zbatimin e kërkesave të përcaktuara në VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë

30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, duke shoqëruar listën e pasurive të dërguara për miratim në me planvendosjen dhe planimetrinë e objekteve.

**18.Gjetje:** Bashkia Patos nuk ka hartuar dhe miratuar “Sistemi i Informacionit Gjeografik, baza e të dhënave GIS”, bazuar në një sistem të kompjuterizuese të regjistrit të informacionit i bazuar ky në një hartë dixhitale, për, mbledhjen përditësimin, ndryshimin ruajtjen, përpunimin, depozitimin, kërkimin dhe rigjetjen e këtij informacioni për objekte gjeografike, karakteristikat e tyre dhe të dhëna të tjera për truallin, tokën me qëllim dhënien e zgjidhjeve ndërvepruese ose vendimmarrëse ndihmuese për detyrat e projektimit, modelimit, analizës, kërkimit etj.

**Rekomandim:** Par të krijuar mundësinë e menaxhimit të pasurive në mënyrë specifike, nga Bashkia Patos të merren të gjitha masat tekniko-organizative për të hartuar dhe miratuar “Sistemin e Informacionit Gjeografik, baza e të dhënave GIS”, bazuar në një sistem të kompjuterizuese të regjistrit të informacionit i bazuar ky në një hartë dixhitale, për, mbledhjen përditësimin, ndryshimin ruajtjen, përpunimin, depozitimin, kërkimin dhe rigjetjen e këtij informacioni për objekte gjeografike, karakteristikat e tyre dhe të dhëna të tjera për truallin, tokën me qëllim dhënien e zgjidhjeve ndërvepruese ose vendimmarrëse ndihmuese për detyrat e projektimit, modelimit, analizës, kërkimit etj.

**19.Gjetje;** Nga Bashkia Patos ka munguar bashkëpunimi institucional, si me ZVRPP Fier por edhe me institucionet e tjera që kanë lidhje me pronat e kërkuara si me Shoqërinë “A.....” sh.a. Patos, me Drejtorinë e Bujqësisë Ushqimit dhe Konsumatorit Fier etj, për të marrë informacion për gjendjen juridike të pronave të kërkuara etj.

**Rekomandim:** Bashkia Patos të marri të gjitha masat tekniko-organizative për të saktësuar për gjendjen juridike të pronave të kërkuara me ZVRPP Fier por edhe me institucionet e tjera si me Shoqërinë “A....” sh.a. Patos, me Drejtorinë e Bujqësisë Ushqimit dhe Konsumatorit Fier etj, për të marrë informacion etj.

**20.Gjetje:** Në mbështetje të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar dhe vendimit të KRRT-së Bashkisë Patos nr. 3, datë 26.12.2003, Këshilli i Bashkisë ka marrë vendimin nr. 4, datë 05.02.2003, me të cilin ka vendosur të miratojë 4 (katër) vendime për dhënie shesh ndërtimi për ndërtimin e objekteve sportive si fusha futbollit-minifutbollit për fëmijë, palestra të mbyllura, ambiente shërbimi, fusha tenisi, hendbolli, parkingje etj dhe konkretisht, **si më poshtë:**

**i.** Për qytetarin B.M sipërfaqe prej 4,780 m<sup>2</sup>, “Për ndërtimin e objekteve sportive palestër e mbyllur, fushë minifutbollit + ambiente shërbimi”.

**ii.** Për qytetarin F.D sipërfaqe prej 4,950 m<sup>2</sup>, “Për ndërtim fushë futbollit për fëmijë + ambiente shërbimi”.

**iii.** Për qytetarin N.M, sipërfaqe prej 4,965 m<sup>2</sup>, “Për ndërtim fushë futbollit për të rinjtë + ambiente shërbimi”.

**iv.** Për qytetarin A.Y sipërfaqe prej 4,970 m<sup>2</sup>, “Për ndërtim pishine, fushë tenisi, fushë hendbolli, parking dhe ambiente shërbimi”.

- Vendimi i KRRT-së Bashkisë Patos nr. 3, datë 26.12.2003 dhe vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 4, datë 05.02.2003, me të cilin ka vendosur të miratojë 4 vendimet e mësipërme, është i kundërligjshëm për arsye se sipërfaqet e mësipërme nuk rezultojnë truall por “tokë arë” dhe ligji nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar, trajton vetëm leje sheshi dhe leje ndërtimi në troje.

- Ligji nr. 7980, datë 27.7.1995 "Për shitjen e trojeve", i ndryshuar, trajton vetëm shitblerjen e trojeve dhe jo tokën arë.

- Prona e mësipërme mbi të cilën është dhënë leje sheshi dhe leje ndërtimi dhe kryer shitblerja nuk ka qenë pronë ligjore e bashkisë, për arsye se kjo pronë nuk ka qenë e regjistruar në Zyrën e regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe për pasojë të katër kontratat shitblerjes nuk kanë fuqi ligjore për faktin se bien në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 195.

- Për 4 (katër) lejet e mësipërme afati kohor i përfundimit të investimeve dhe mbarimit të afatit të lejeve të ndërtimit ka qenë 16.12.2003 dhe nga qytetarët e pajisur me këto leje ndërtimi nuk kanë kërkuar shtyrje të afatit të lejeve të ndërtimit.

- Lejet e ndërtimit të miratuara për këto objekte nuk janë zbatuar, pasi objektet e përcaktuara në çdo leje ndërtimi nuk janë ndërtuar dhe për pasojë nuk janë kryer akt-kolaudimet, nuk janë dhënë lejet e shfrytëzimit në zbatim të neneve 12 dhe 13 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim”, i ndryshuar dhe për rrjedhojë nuk janë kryer pagesat për 50 % e kështit të dytë të vlerës së trullit.

- Për sa trajtuam më sipër vendimi i Këshillit Bashkiak si dhe vendimet e KRRT-së **janë akte administrative relativisht të pavlefshme** dhe nuk kanë fuqi ligjore.

**Rekomandim:** Bashkia Patos të ndjektë të gjitha hapat ligjorë për të rregulluar pasojat e zbatimit të vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 4, datë 05.02.2003.

## **21. Gjetje:**

- Në bazë të Aktmarrëveshjes datë 24.02.1994 midis sindikatave: Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH), Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, Organizatës së Sindikatës Pavarur të Naftës Patos dhe Sindikatës së Pavarur të Porteve, mbi zbatimin e Dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë nr. 204, datë 05.06.1992, Organizata e Sindikatës së Pavarur të Naftës Patos, përfitoi nga ndarja fizike e pasurisë, **Pallatin e Kulturës Patos.**

- Në zbatim të Dekretit të Presidentit nr. 204, datë 05.06.1992 “Për pasurinë e Sindikatave”, Sindikata e Naftës Patos më datën 07.03.1995, ka bërë hipotekimin e Pallatit të Kulturës Patos me notë transkriptimi 211.

- Sindikata e Naftës Patos më datën 14.03.1995 me kontratën e shitblerjes nr. 1149, para noteres N.K, ka bërë shitjen e **10 dhomave** të këtij objekti në favor të N.H, i cilin ka kryer hipotekimin sipas notës së transkriptimit 234.

ZVRPP Fier më datën 30.04.2012 ka bërë regjistrimin në hipotekë të kësaj prone më datën 30.04.2002, në favor të N.H.

- Bazuar në VKM nr. 153, datë 03.04.1993 “Për kalimin e objekteve, të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”, Ministria e Ekonomisë e Privatizimit me shkresën nr. 1019/1, datë 16.08.1998, kalon objektin “Pallati i Kulturës” Patos, nga Shoqëria “A....” sh.a. në pronësi të Bashkisë Patos.

Me urdhrin nr. 343, datë 22.09.1998 të Ministrisë së Pushtetit Lokal dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Privatizimit “Pallati i Kulturës” Patos, kalon në pronësi të Bashkisë Patos.

- Bashkia Patos me dokumentin hipotekar nr. 93, datë 25.02.2003, ka kryer regjistrimin në hipotekë në ZVRPP Fier, për sipërfaqen prej 1103,25 m<sup>2</sup>.

Proceset gjyqësore ndërmjet Bashkisë Patos (e përfaqësuar nga Avokati i Shtetit) dhe Sindikatës Pavarur të Naftës Patos, për fitimin e pronësisë me objekt: “Pallati i Kulturës” Patos.

**22.Rekomandim:** Bashkia Patos në zbatim të kërkesave ligjore të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Rregullores së ZQRPP me nr 184, datë 08.04.1999 “Për punën në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” e ndryshuar, të aplikojë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier për të regjistruar gjithë sipërfaqen e Pallatit të Kulturës, dukë paraqitur plan rilevimin e Pallatit të Kulturës të hartuar nga një topograf i licencuar së bashku me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 2600/489 i Regjistrimit Themeltar me nr. i 129 i Vendimit, viti 2005.

## **A. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar, kreu IV, neni 9-14, të ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109, nga Bashkia Patos të nxirren aktet administrative, të kryen kontabilizimet dhe të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën **8,310,700 lekë**, si me poshtë:

**1.Gjetje:**Në kundërshtim me kërkesat e pikës 12, paragrafi i V, si dhe lidhjes 2 e 7, të VKM-së nr. 1619, datë 02.07-2008, “Për klasifikim e funksioneve e grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin, e kufijve të pagave të punonjësve të qeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM-në nr. 518, datë 16.08.2012 dhe VKM-në nr. 586, datë 17.07.2013, janë bërë pagesa të kundërligjshme për 8 punonjës në vlerën **923,269 lekë**.

**Rekomandim:** Të bëhet kontabilizimi, si dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën 923,269 lekë, nga punonjësit si me poshtë:

1- B.B	në vlerën 464,687 lekë
2- A.DH	në vlerën 48,472 lekë
3- S.B	në vlerën 41,134 lekë
4- E.G	në vlerën 45,472 lekë
5- I.Ç	në vlerën 97,148 lekë
6- H.M	në vlerën 17,006 lekë
7- E.H	në vlerën 46,377 lekë
8- D.L	në vlerën 163,973 lekë

**2. Gjetje:** Në kundërshtim me pikën 11, të VKM nr. 864 datë 23.07.2010 “Për pajisjen me telefoni celular të personave juridik e publik “, janë përballuar shpenzimet e telefonisë të lëvizshme, nga buxheti i bashkisë në favor të Kryetares së Bashkisë me një efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit për vlerën **135,000 lekë**.

**2.1.Rekomandim:** Të behet kontabilizimi dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e vlerës 135,000 lekë, nga

1-R.B për vlerën 135,000 lekë.

**3.Gjetje:** Në kundërshtim me nenin 8/1 “Të ardhurat të përjashtuara”, të ligjit nr. 8438, datë 20.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, për dëmshpërblimin në pagë me vendim të formës të prerë të gjykatës Apelit Vlorë, në favor të kreditorit Roland Muskaj në vlerën 1,345,000 lekë, nuk është aplikuar tatim mbi këto të ardhura në masën 10 %, me një efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit, në vlerën **133,500 lekë** .

**Rekomandim:**Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **133,500 lekë**, nga punonjësi Roland Muskaj në vlerën **1,345,000 lekë**.

**4. Gjetje nga auditimi :** Në kundërshtim me shkronjat (dh,ë) të nenit 12, të ligjit nr. 10296 datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, si dhe të nenit 36, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, janë të pa argumentuara me dokumente konsumi 165.74 litra naftë dizel nga dy autoveturat të administratës së Bashkisë me një efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën **301,361 lekë**.

**Rekomandim:** Të bëhet kontabilizimi dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën 301,361 lekë nga punonjësit si me poshtë:

1- R.B	në vlerën 43,051.57 lekë
2- A.V	në vlerën 43,051.57 lekë
3- V.Zh	në vlerën 43,051.57 lekë
4- M.Sh	në vlerën 43,051.57 lekë
5- A.G	në vlerën 43,051.57 lekë
6- N.Xh	në vlerën 43,051.57 lekë
7- F.Ll	në vlerën 43,051.57 lekë

**5. Gjetje:** Në kundërshtim me nenin 20 të kreut të III-të të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nga Autoriteti Kontraktor është futur si kriter vlerësues, jashtë objektit të këtij prokurimi që është “Rikonstruksioni i Shkollës së mesme “Zhani Ciko”, kriteri që “Kandidatët/ofertuesi duhet të jenë të pajisur me licencë nga QKL për shërbimet e ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyje e kullota”, kriter ky diskriminues, pasojë e të cilit është skualifikimi i operatorit ekonomik “A...I....G Konstruksion” sh.p.k me vlerë të ofertës 40,050,046.8 lekë më tvsh, dhe kualifikimi i “4....A” me ofertë 42,966,760.8 lekë me një efekt financiar në dëm të buxhetit të shtetit në vlerën **2,916,714 lekë me tvsh**.



**Rekomandim:** Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën 2,916,714 lekë nga punonjësit si me poshtë:

- 1- R.B në vlerën 729,178 lekë
- 2- L.S në vlerën 729,178 lekë
- 3- D.K në vlerën 729,178 lekë
- 4- K.A në vlerën 729,178 lekë

**6.Gjetje:** KVO në tenderin me objekt “Ndërtim Lulishte Parafabrikat” ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, shkronja “d”, neni 2 germa “a” dhe “c” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, gjatë vlerësimit dhe kualifikimit të ofertave, sepse është skualifikuar bashkimi i operatorëve ekonomikë “C...R sh.p.k & Sh-M sh.p.k” me ofertë 4,826,095.2 lekë me TVSH për mungesë të njëjtit dokument të kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, dokument ky që i mungonte dhe operatorit ekonomik fitues “N... 1934 shpk” me vlerë 5,729,424 lekë me TVSH.

Si rezultat i këtij veprimi të kundërligjshëm është shkaktuar një dëm ekonomik buxhetit të shtetit në vlerën **903,328 lekë** me TVSH.

**Rekomandim:** Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën 903, 326.8 lekë nga punonjësit si me poshtë:

- V.ZH në vlerën 301,109 lekë
- N.C në vlerën 301,109 lekë
- H.B në vlerën 301,109 lekë

**7.Gjetje:** Në prokurimin elektronik të tenderit me objekt “Rikonstruksion i shkollës së mesme Zhani Ciko, Patos”, fondi limit i llogaritur nga autoriteti kontraktor nuk është i saktë si pasojë e mos referencës në zërat e punës të këtij preventivi tek “Manualit Teknik të Çmimet të Ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, **i miratuar ky manual me VKM nr.568 date 27.12.2013** “Për miratimin e manualit teknike të çmimit të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Si përfundim, janë preventivuar më tepër në fond limit, duke i shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të shtetit **710,124 lekë**, për zëra jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve, (1,148,113 – 381,289).

**Rekomandim:** Të kontabilizohet dhe të ndiqet te gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **710,124 lekë** nga punonjësi, A.K.

**8.Gjetje:** Drejtoria e Taksave Vendore nuk ka marrë masa për subjektin “M..G” për aktivitetin “Bar Kafe” në godinën e Bashkisë Patos dhe subjektin “M...S” me aktivitet “Klinikë Dentare”, të cilët nuk kanë arkëtuar në buxhetin e shtetit detyrimet në vlerë **241,000 lekë**, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 15.05.2008, neni 40 pika “1”, si dhe ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, dhe neni 41 Pika 3 dhe 4.

**Rekomandimi:** Të kontabilizohet dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **241,000 lekë** nga:

- M.G në vlerën 200,000 lekë.
- M.S në vlerën 41,000 lekë.

**9.Gjetje:** Në drejtimin të zbatimit të kontratave të objekteve: “Rikonstruksion i Rrugës Kripallarë”, “Rikonstruksioni i trotuarit të sipërm në Shëtitoren Republika Patos”, “Ndërtim i lulishtes te parafabrikatet”, “Rikonstruksion i Rrugës Këshilltarët, në lagjen 1 Maj”, “Rikonstruksion i Rrugës Burimi i Xanës”, “Rikonstruksion i Rrugës Demokracia”, “Blerje rërë bituminoze” në kundërshtim me neni 7 dhe neni 12 të ligjit nr. 8402 datë 10.09.1968 ku rezultuan punime të pa kryera me një efekt financiar në dëm të buxhetit në **vlerën 1,470,664 lekë**.

**Rekomandimi:** Të kontabilizohet dhe te ndiqen të gjitha rrugët ligjore për shpërblimin e dëmit në vlerën **1,470,664 lekë** nga operatorët:

-Nga operatori ekonomik “Sh...” shpk, për zbatimin e objektit, e “Rikonstruksionin e Rrugës Demokracia” për vlerën **315,600 lekë**.

-Nga operatori ekonomik “S...i” shpk, në “Rikonstruksionin e shëtitores Republika” në vlerën **325,000 lekë**.

-Nga operatori ekonomik "N.." shpk, për "Ndërtim i Lulishtes te Parafabrikat" në vlerën **183,000 lekë**.

-Nga operatori ekonomik "Sh..." shpk, për "Rikonstruksioni i Rrugës Burimi i Xanes" në vlerën **193,540 lekë**.

-Nga operatori ekonomik "Sh..." shpk, për "Blerje rërë Bituminoze" në vlerën 94,304 lekë.

-Nga operatori ekonomik "S.." shpk, për "Rikonstruksion i Rrugës Këshilltarët" në vlerën **209,100 leke**.

-Nga operatori ekonomik "H...& H...." për "Rikonstruksion i rrugës Kripllarë" në vlerën **150,120 lekë**.

**10.Gjetje:** Sipas fletëdaljes nr. 33, datë 24.04.2014 Ndërmarrja e Rregullimit të Territorit Patos ka bërë dalje 1300 m2 pllaka me çmim 780 lekë/m2, në vlerën 1,014,000 lekë për objektin "Trotuari i Shëtitores Republika", bazuar në aktmarrëveshjen nr. 863/19, datë 16.12.2013 të nënshkruar ndërmjet titullarit të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik "S....".

Ndryshimi i kushteve të kontratës nëpërmjet aktmarrëveshjen nr. 863/19, datë 16.12.2013, është në kundërshtim me nenin 35, Negociatat dhe Amendamentet, të KPK (DST), **pasi kjo marrëveshje ka ndryshuar vlerën e ofertës dhe se përmbajtja e marrëveshjes nuk i është nënshtruar procedurave konkurruese.**

Sipas situacionit përfundimtar sipërmarrësi ka situacionuar këtë zë të preventivit në vlerë prej 953,600 lekë (3/62 Trotuar me pllaka granili me bojë pa bordurën e betonit + shtrese 6 cm beton sasia 1,192 x800 lekë/m2 nga 1,200 lekë/m2 të paraqitur në tender ose me diferencë më pakë 400 lekë/m2).

Ky veprim është në kundërshtim me DST (Projektin e zbatimit dhe preventivin), nga i cili ka rezultuar **dëm ekonomik në vlerën 494,000 lekë** (i llogaritur diferencë ndërmjet çmimit për m2 të zbritur në situacionin përfundimtar dhe çmimit të blerjes nga Bashkia Patos).

Veç kësaj subjekti ka përdorur 1198m2 nga 1300 m2 të bërë dalje nga magazina me një diferencë 108 m2 më pak, **ose në vlerën 84,240 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik të arkëtueshëm nga kontraktuesi.

**10.1.Rekomandim:** Bashkia Patos të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët ligjorë për arkëtimin e pagës të përfituar padrejtësisht **në shumën 578.240 lekë** nga operatori ekonomik "S...." sh.p.k, difference çmimi në zërin 3.62 Trotuar me pllaka granili me bojë pa bordurën e betonit + shtrese 6 cm beton në tenderin e zhvilluar me objekt "Rikonstruksion i trotuarit në Shëtitoren Republika".

#### **B/1. MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE:**

**1.Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të prokurimit në tenderat e zhvilluar, u konstatuan se në 9 raste me vlerë kontrate kontrate 78,585,845 lekë (pa TVSh), ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, eficientë dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe përdorimin me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën totale **15,626,332 lekë**, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar.

**Rekomandimi:** Bashkia Patos të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficientë të fondeve publike, për 4 procedurat e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **15,626,332 lekë**, duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

#### **C. MASA ADMINISTRATIVE:**

**C.1.** Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Patos, u konstatuan mangësi dhe shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik".

Bazuar në germën “ç” të nenit 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 7, pika 2, 3/a, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72, të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, të shqyrtojë dhe të marrë masa disiplinore ndaj Titullarit të Autoritetit Kontraktor, anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe Njesisë së Prokurimit, **konkretisht:**

### **1.Zj. R.B, Kryetar i Bashkisë Patos, në cilësinë e titulluarit të autoritetit kontraktor.**

#### **Për arsye se:**

Në procedurat me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratë e zhvilluara për vitin 2013 dhe 2014, me objekt:

1 Blerje karburanti për Bashkinë Patos dhe ndërmarrjet vartëse (procedure emergjente), me fond të kontraktuar gjithsejtë në vlerën 600 mijë lekë.

2. Ndërtim muri mbajtës ne lagjen “Mustafa Matohiti, me fond të kontraktuar gjithsejtë në vlerën 1,801 mijë lekë.

3. Blerje ushqime për kopsht e çerdhe, procedure me lote(ne kushte emergjente) 1 me fond të kontraktuar gjithsejtë në vlerën 151 mijë lekë.

4. Blerje ushqime për kopsht e çerdhe, procedure me lote(ne kushte emergjente) 2 me fond të kontraktuar gjithsejtë në vlerën 279 mijë lekë.

5. Rikonstruksion i rrugës Kripallare , me fond të kontraktuar gjithsejtë në vlerën 1,493 mijë lekë.

6. Rikonstruksion i Trotuarit ne Shëtitoren Republika , me fond të kontraktuar gjithsejtë në vlerën 1,108 mijë lekë.

7. Rikonstruksion i rrugës Burimi i Xanës, me fond të kontraktuar gjithsejtë në vlerën 447 mijë lekë, paraqet argumentin se është në kushtet e emergjencës, argument i cili nuk qëndron, pasi është në kundërshtim me germën “c”. pika 2, Neni 33 Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nuk përmbushen asnjë nga kushtet e përcaktuara në germën “a”, pikën 5, Kreun e IV, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, **pasi neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure.**

Zgjedhja e procedurës së prokurimit me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës, në tenderat e cituar më sipër, është në kundërshtim me nenin 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut IV, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për arsye se janë ndryshuar dokumentet e të tenderit, në procedurën me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës.

Kontratat janë lidhur në kundërshtim me nenet 1 “Objekti dhe qëllimi”, 2 “Parimet e përzgjedhjes”, 4 “Fusha e zbatimit” dhe 29 “Procedurat standarde të prokurimit”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik, për arsye se autoriteti kontraktor, në përcaktimin e fituesit, nuk ka zbatuar procedurat e parashikuara në këtë ligj, duke cenuar parimet e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë i ofertuesve dhe parimin e transparencës në procedurat e prokurimit, me pasojë favorizimin e një operatori ekonomik të caktuar të zgjedhur nëpërmjet procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

-Në **7 raste** në vlerën **64.821.924 lekë**, ka realizuar procedurën e prokurimit publik në mungesë të fondeve, në kundërshtim me pikën 4/c të kreut V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 50, të ligjit 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

2. **z.A.V** në cilësinë e Kryetarit dhe anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

3. **znj. V.Zh**, në cilësinë e Kryetarit dhe anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,

4. **z. V.N**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
5. **znj. A.L**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
6. **z. N.C**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
7. **znj. N.M**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.
8. **z.H.B**, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

**Për arsye se:**

**KVO ka përdorur dy standarde të ndryshme në vlerësimin e kriterëve të kualifikimit të operatorëve pjesëmarrës në procedurat e zhvilluara për periudhën 2013-2014.** Konkretisht, ka skualifikuar për mangësi të konstatuara në dokumentacionin, ekonomik, financiar dhe teknik për plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit të gjithë operatorët ekonomik, por këto mangësi lehtësisht mund të konsideroheshin devijime të vogla pasi nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës; dhe nga ana tjetër ka kualifikuar dhe e ka shpallur fitues vetëm 1 operator ekonomik kur dokumentacioni i paraqitur për të vërtetuar kapacitetet ekonomike, financiare dhe teknike është në kundërshtim me DST ( kriteret e veçanta të kualifikimit ), nenin 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe me piken 4, të Kreut V, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar. Për pasojë nga ky veprim nuk është përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të beje, me mirepordorimi i fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke i bërë që fondet të mos përdoren me efektivitet dhe të mos kursohen në favor të buxhetit të bashkisë Patos.

9. **znj. L.S**, në cilësinë e Juristit të Njesisë së Prokurimit
10. **znj. D.K**, në cilësinë e Juristit dhe Specialistit të Njesisë së Prokurimit
11. **z. B.P**, në cilësinë e Specialistit të Njesisë së Prokurimit
12. **z. K.A**, në cilësinë e Specialistit të Njesisë së Prokurimit
13. **z. Y.M**, në cilësinë e Specialistit të Njesisë së Prokurimit
14. **znj. B.T**, në cilësinë e Specialistit të Njesisë së Prokurimit

**Për arsye se:**

-Në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ka shkelje të dispozitave, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomike më të favorshme nuk i plotësojnë kushtet e nenit 55, pika 1, e LPP-së, pasi nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderave.

-Kriteret e përdorura për vlerësimin e ofertave nuk janë specifikuar në mënyrë të saktë nga ana e autoritetit kontraktor, për rrjedhojë lejojnë Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, t'i interpretojnë ato në mënyra të ndryshme në procedurat të ndryshme madje në disa raste me impakte financiar në dëm të autoritetit kontraktor ***në vlerën 15,626,332 lekë nga e cila 2,458,440 lekë në 2 kontrata me vlerë 14,284,210 lekë në vitin 2013 dhe 13,167,892 lekë në 7 kontrata me vlerën 65,417,953 lekë në vitin 2014.***

-Dokumentet e kërkuara për të vërtetuar realizimin e kriterëve të kualifikimit, nuk kanë argumentim me hollësi të tyre, kjo në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, Kreu III, pika 3, germa “a” si dhe me nenin nr. 46 të LPP-së, pikën nr. 3. Nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në Ligjin e Prokurimeve Publike (LPP) dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomik, veçanërisht biznesit të vogël. Kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

**C/2.** Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” neni 15, ndryshuar me nenin 2, të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007, për shkelje të nenit 7, pikat 1, 3, 4, 17, 18 dhe 19, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, pikat, 8, 8/1, 8/2 dhe 10, të Kreut II dhe pikat 4 dhe 5, të Kreut III të UKM nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, Bashkia Patos, **të vendosë masë administrative me gjobë për subjektin “H.. sh.p.k,** dhe “Blerimi “shpk e inxhinierë **F.G dhe Ing. T.N** , nën cilësinë e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderëve në përmjet likuidimit të punimeve të pakryera, më konkretisht në tenderin “Rikonstruksion i rrugës Kripallare” Patos , për likuidimin e punimeve të pakryera në disa zëra për dy kategori punimesh në objektin, likuidimin e punimeve mbi ato të parashikuara, të ofertuara dhe të miratuara nga vetë Titullari dhe projektuesi, mangësi në dokumentacionin e dosjes teknike, veprime në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, nenin 1, nenin 7, pika 3, pika 4, pika 6 dhe pika 9 e kontratës së mbikëqyrjes nr. 4/122 – 231/2014 me nr. 1422/6 prot, datë 07.08.2014 lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier dhe Shoqërisë mbikëqyrëse “Ersi/M” sh.p.k ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e mbikëqyrësit të punimeve si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 3.2, 3.3 dhe pika 4, paragrafi 4.

## **B. MASA DISIPLINORE:**

Mbështetur në nenin 15, të ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij si dhe mbështetur në kreun IV, neni 11, germa” e”dhe “ç dhe neni 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995” Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” , i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Patos, fillimin e procedurave e masave disiplinore nga **“Vërejtje”** deri në **“Largim nga detyra”** dhe për punonjësit me kontratë, nga **“Vërejtje”** deri **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**,si më poshtë:

**1.Z. A.S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Biznesit të Vogël.**

**2.Znj. S.M, me detyrë Inspektore e taksës së popullatës.**

**3.Z. E.Sh, me detyrë Inspektor i tatim taksave në terren.**

**4.Z. K.H, me detyrë Inspektor i tatim taksave në terren**

Për të metat e konstatuara dhe konkretisht:

-Për **2** subjekte të cilat kanë marrë dy ambiente me qira nga asetet e bashkisë dhe **nuk** ka qenë të regjistruar në QKR, nuk i është marrë asnjë detyrim mbi aktivitetin e kryer shërbime me qiramarrësin **M.S** “Klinikë Dentare” dhe “Bar kafe” në ambientet e Bashkisë Patos me detyrim i pa arkëtuar nga qiramarrësi **M.G** në buxhetin e shtetit në vlerën totale **241,000 lekë** si rezultat i mos veprimit, nga Drejtoria e Taksave Vendore si dhe mosbashkëpunimin me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, në kundërshtim me ligjin nr.9920, datë 15.05.2008, neni 40 pika “1”.

- Mos kryerje kontrolli vendosja e taksave subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë me qarkullim nën 2 milion lekë për 63 përqind të subjekteve “sa xhiro e një ambulanti”.

-Mos mbajtur dokumentacion për sipërfaqet e mbjella pemëtoresh, ullishte, vreshtari, për të saktësuar taksën sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemimin e Taksave Vendore”, neni 23, pika 3.

- Për subjektet debitorë, nuk disponohet një regjistër me të gjitha të dhënat dhe modalitetet për secilin subjekt, nuk janë të kontabilizuara në sektorin e financës, nuk kanë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **8,125,872 lekë** në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenit 12 të tij, si dhe Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve”, pika 88 dhe pika 89.2, pika 89.3.

### **5.Z. B.B, me detyrë Përgjegjës dhe Krveyspektori i INUV**

Për të metat e konstatuara dhe konkretisht:

- Mos vendosje sanksioni e masë administrative me gjobë për shkeljet e konstatuara në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”.

-Mos vendosje sanksioni e masë administrative me gjobë për shkeljet e konstatuara në vitin 2014 në **44 raste** në kundërshtim me ligjin nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikim e territorit”, konkretisht Neni 82, pika 10 dhe në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014, miratuar në datë 31.07.2014 “Për planifikim dhe zhvillimin e territorit”, Neni 52, pika 1, germa “g”.

- për mos zbatim të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e ai Vendor”, për kontrollin në mënyrë të planifikuar të territorit, me qëllim parandalimin e ndërtimeve pa leje brenda territorit të bashkisë, si dhe marrjen e masave në kohë për parandalimin e tyre.

- procesverbalet e hartuara nuk janë të shoqëruara me asnjë masë administrative me gjobë, në kundërshtim me nenin 82, të ligjit nr. 10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, i ndryshuar, si dhe nenin 52, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikim dhe zhvillimin e territorit”.

- nuk janë planifikuar dhe kryer kontrole në drejtim të:

i. Ushtrimit të kontroleve periodike për stafin teknik të zbatimit për cilësinë e materialeve të ndërtimit si dhe dokumentacionin e detyrueshëm që duhet të mbahet në objekt;

ii. provave laboratorike të materialeve që përdoren në ndërtimin e objekteve, kryesisht betone, hekur, llaçe, inerte etj;

iii. në drejtim të mbikëqyrjes nga specialist të licencuar dhe kolaudimit pas përfundimit të tyre;

iv. në drejtim të projekteve të zbatimi të ndërtimeve pa leje si dhe gjithë detyrave që përcakton në mënyrë më analitike VKM nr. 862, datë 05.12.2007.

### **6.Z. L.Y, me detyrë Krveyspektor i Policisë Bashkiake**

Për të metat e konstatuara dhe konkretisht:

- Mos mbajtja e dokumentacionit në përputhje të plotë me nenin 35 të Rregullores së Brendshme “TIP” të Policisë së Bashkisë dhe Komunës, mangësi në dokumentacion dhe në hartimin e tyre konform legjislacionit.

- Nuk është marrë asnjë masë administrative me gjobë, në rastet e kundërvajtjeve të konstatuara ndaj kundërvajtësve, kjo në kundërshtim me nenin 13, të ligjit nr.8224 datë 15.05.1997, paragrafi i parë.

### **7. Znj. M.Sh, me detyrë Drejtore e Financës:**

Për të metat e konstatuara dhe konkretisht:

- Mos ndalim, të tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin në pagë, në favor të kreditorit Roland Muska dhënë me vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit Vlorë në Vendimin e saj nr. 710, datë 28.06.2012, duke vepruar në kundërshtim me nenin 8/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Dëm ekonomik në vlerën **135 mijë lekë** .

- Mos marrje mase për shpenzim të pa justifikuar në vlerën **126 mijë lekë** për përballimin e telefonisë së lëvizshme nga artikulli 602 në favor të kryetares së Bashkisë, shpenzim ky në kundërshtim me VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pasjet me nr të telefonit celular të personave juridik e fizik”.

- Mos ndjekje të veprimeve të kryera me arkë dhe në magazinë ku rezultoi me veprime të kundërligjshëm i ndjekjes së normativës së harxhimit të karburantit, për dy autovetura të administratës të kësaj Bashkie, me një dëm të buxhetit për **301,361 lekë**.

-Mos ndjekje procedurave ligjore, janë bërë pagesa të kundraligjshme për 8 punonjës në vlerën **923,269 lekë**.

#### **8. Znj. A.L, me detyrë Drejtore e të Ardhurave Lokale.**

Për të metat e konstatuara dhe konkretisht:

-Për **2** subjekte të cilat kanë marrë dy ambiente me qira nga asetet e bashkisë dhe **nuk** ka qenë të regjistruar në QKR, nuk i është marrë asnjë detyrim mbi aktivitetin e kryer shërbime me qiramarrësin **M.S** “Klinikë Dentare” dhe “Bar kafe” në ambientet e Bashkisë Patos me detyrim i pa arkëtuar nga qiramarrësi **M.G** në buxhetin e shtetit në vlerën totale **241,000 lekë** si rezultat i mos veprimit, nga Drejtoria e Taksave Vendore si dhe mosbashkëpunimin me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 15.05.2008, neni 40 pika “1”.

- Për subjektet debitorë, nuk disponohet një regjistër me të gjitha të dhënat dhe modalitetet për secilin subjekt, nuk janë të kontabilizuara në sektorin e financës, nuk kanë ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **8,125,872 lekë** në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenit 12 të tij, si dhe Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve”, pika 88 dhe pika 89.2, pika 89.3 dhe pika 96.

-Mos planifikim të saktë të ardhurat të taksës vendore të subjekteve të biznesit të vogël, të biznesit të madh, taksës së pastrimit, taksës së regjistrimit, taksës së popullatës, taksës së ndërtesës e pasurisë, taksës së pastrimit të popullatës, taksën e tokës bujqësore në vlerën **26,922,000 lekë** lekë për vitin 2013-2014 në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenin 12.

-Mos marrje masa për tregun ushqimor të qytetit, mos saktësim dhe dokumentim të sipërfaqeve që disponojnë subjektet që kryejnë aktivitet tregtar sipas llojit të aktivitetit sipas VKB nr. 44, datë 16.11.2012 dhe VKB nr. 39, datë 26.11.2013, ku saktësohet se “**Baza e taksës së përkohshme të tregut është sipërfaqja në m<sup>2</sup> e cila vihet në shfrytëzim për tregtim artikuj të ndryshëm brenda territorit të përcaktuar**”, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenit 32 “taksa të tjera”, pika 2, germa “b”, si dhe Rregullores nr. 20, datë 28.05.2014.

#### **9.Z. Sh.B, me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore**

Për të metat e konstatuara dhe konkretisht:

-Mos ndjekje të procedurave ligjore në emërimin e punonjësve të Policisë Bashkiake, janë bërë në kundërshtim të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, neni 4 i tij ligji si dhe Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003 dhe Ministrit të Rendit Publik, nr. 823, datë 11.04.2003.

-Mos ndjekje te procedurave ligjore ne emërimet e kryeinspektori dhe inspektorët e INUV në Bashkinë Patos, në kundërshtim të plotë me kërkesat e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, e konkretisht nenit 11, “Kryeinspektorët e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku/ kombëtar, duhet të kenë arsimin te lartë të nevojshëm profesional në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.

- Mos ndjekje të procedurave ligjore në Bashkinë Patos të punonjësve që nuk plotësojnë kriteret për të qenë auditues të brendshëm pa u pajisur me certifikatë si auditues i brendshëm në kundërshtim me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, kreu VI, Audituesi i Brendshëm, Neni 19 Punësimi, Pika 2.

-Mos ndjekje procedurave ligjore në kundërshtim me kërkesat e pikës 12, paragrafi i V, si dhe lidhjes 2 e 7 të VKM me nr. 1619, datë 02.07-2008, “Për klasifikim e funksioneve e grupimin e njërive të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin, e kufijve të pagave të punonjësve të qeverisjes vendore” i ndryshuar me VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe VKM

nr.586, datë 17.07.2013, janë bërë pagesa të kundraligjshme për 8 punonjës në vlerën **923,269 lekë**.

#### **10. Z. H.M, me detyrë Drejtor i Njësisë së Auditimit të Brendshëm**

Për të metat e konstatuara dhe konkretisht:

- Mos zbatuar rekomandimet e dhëna nga Drejtoria e Auditimit dërguar njëjësive vartëse dhe të miratuara dhe urdhëruara nga titullari i institucionit, nuk ka ushtruar funksionet e tij në mënyrë objektive sipas ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditin e brendshëm në sistemin publik”, neni 7, neni 11 pika (c), si dhe neni 14 pika ‘ë’, i ndryshuar dhe sipas rregullores me nr. 20, datë 28.07.2014 që saktëson qartë misionin e NJAB, si dhe “Manualit të Auditimit të Brendshëm”, të përgatitur nga Njësia Qendrore e Harmonizimit nr. 69, datë 29,09,2010, për Auditimin e Brendshëm”, për arkëtimin e dëmit të shkaktuar në vlerën **534,000 lekë** nga 18 subjekte, për mos arkëtim të detyrimit taksë ndërtese në vlerën **1,216,000 lekë**, për taksën e tokës **1,241,000 lekë**, taksë e tarifa e gjelbërimit në vlerë **2,199,000 lekë**, të cilat janë trajtuar në auditimet nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

#### **11.Znj.S.G, me detyrë Përgjegjëse e zyrës së Kadastrës**

Për të metat e konstatuara dhe konkretisht:

-Nuk kanë mbajtur dokumentacion për sipërfaqet e mbjella pemëtoje, ullishte, vreshtari, në kundërshtim me Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, neni 23, pika 3, ku shprehimisht thuhet “Përfshihen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes”.

-Nuk ka regjistër elektronik sipas viteve, për të nxjerrë të dhëna të sakta, sipërfaqet që disponon çdo qytetar, kategorinë e bononitetin e tokës, detyrimin e taksës së tokës si dhe vlerën e likuidimit.

-Sipas regjistrimit të mbajtur manualisht janë të regjistruara 2481 familje ku sipas të dhënave nga zyrat e gjendjes civile në fshat janë 2914 familje, pra për **433 familje** nuk kanë asnjë të dhënë dhe nuk janë regjistruar për sasinë e tokës që kanë në përdorim si dhe tarifën e taksës bujqësore.

-Nuk janë planifikuar dhe nuk janë realizuar të ardhura nga toka bujqësore në kundërshtim me nenin 23 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, pika 1 dhe pika 2, si dhe nenit 24 “Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave”,si dhe nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, me nenin 27, “Mbajtja e regjistrimeve” .

Për r mos planifikim të saktë të ardhurave në vitin 2013, taksa e tokës bujqësore për popullatën në vlerën **3,634 mijë lekë** e pa planifikuar e ardhur e mugar në buxhetin e shtetit.

#### **12. Znj. N.M, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe të Kontrollit të Zhvillimit të Kadastrës;**

#### **13. Z. R.B, me detyrë specialist urbanistike dhe**

#### **14. Z. I.K me detyrë jurist.**

Për të metat e konstatuara dhe konkretisht:

- Nuk kanë zbatuar plotësisht kërkesat e dispozitave ligjore për procedurat e transferimit të pronave në NJQV-ve dhe konkretisht të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 15, datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferim në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”.

Nga Bashkia Patos nuk janë zbatuar pika 6, e VKM së mësipërme e cila përcakton shprehimisht:

“ZVRPP përgatit listat e pronave shtetërore, të regjistruara ose në proces, për çdo zonë kadastrale, posaçërisht për miratimin e inventarit nga Këshilli i Ministrave. Këto lista duhet të sqarojnë çdo pronë: indeksin e hartës, numrin e pasurisë, adresën, llojin e pronës, sipërfaqen e pronës dhe çdo specifikim tjetër, të nevojshëm, që ndodhet në ZVRPP”.

-pika 7 e VKM së mësipërme e cila përcakton shprehimisht:



“ZVRPP-të e rretheve janë të detyruara të lejojnë përfaqësuesit e autorizuar të organeve të pushtetit vendor dhe të organeve të qeverisjes vendore të shfrytëzojnë, për efekt të zbatimit të këtij vendimi, “Librin e ngastrave” dhe kartelat e regjistrimit të pasurive dhe pika 13 e VKM së mësipërme.

Nga auditimi rezultoi se lista e pasurive të dërguara për miratim në asnjë rast nuk shoqërohet me planvendosjen dhe planimetrinë e objekteve”.

- Nuk kanë hartuar dhe miratuar “Sistemin e Informacionit Gjeografik, baza e të dhënave GIS”, bazuar në një sistem të kompjuterizuese të regjistrimit të informacionit i bazuar ky në një hartë dixhitale, për, mbledhjen përditësimin, ndryshimin ruajtjen, përpunimin, depozitimin, kërkimin dhe rigjetjen e këtij informacioni për objekte gjeografike, karakteristikat e tyre dhe të dhëna të tjera për truallin, tokën me qëllim dhënien e zgjidhjeve ndërvepruese ose vendimmarrëse ndihmuese për detyrat e projektimit, modelimit, analizës, kërkimit etj.

- Nuk kanë marrë masat e duhura për të kryer bashkëpunimin institucional, si me ZVRPP Fier por edhe me institucionet e tjera që kanë lidhje me pronat e kërkua si me Shoqërinë “A....” sh.a. Patos, me Drejtorinë e Bujqësisë Ushqimit dhe Konsumatorit Fier etj, për të marrë informacion për gjendjen juridike të pronave të kërkua etj.

- Nuk kanë ndjekur të gjitha hapat ligjorë për të rregulluar pasojat e zbatimit të vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 4, datë 05.02.2003.

- Nuk kanë zbatuar kërkesat ligjore të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe Rregullores së ZQRPP me nr 184, datë 08.04.1999 “Për punën në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” e ndryshuar, të aplikojë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier, për të regjistruar gjithë sipërfaqen e Pallatit të Kulturës, dukë paraqitur plan rivegimit të Pallatit të Kulturës të hartuar nga një topograf i licencuar së bashku me vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 2600/489 i Regjistrimit Themeltar me nr. i 129 i Vendimit, viti 2005.

Nga Bashkia Patos, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë në process vlerësimi e zbatimi.**

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Hysen Metko, Genc Koka, Mirland Cela, Junild Hoxha, Ramadan Zejnuni, Shefki Jaupi dhe Pllumb Beqiraj , më tej u shqyrtua nga z. Selfo Zeneli kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT